



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
GJIROKASTËR

ANALIZË
E TREGUESVE KRYESORË TË PUNËS PËR VITIN 2018

DREJTUAR:
PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Znj. ARTA MARKU
TIRANË

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, si organ i ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim, ka përmbushur për periudhën 01 janar-31 dhjetor 2018, detyrat në fazat e hetimeve paraprake, të gjykimit, të ekzekutimit të vendimeve penale, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara ne aktet ligjore:

-*Ligjin Nr.76/2016*, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8417”, datë 21.10.1998”, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar, Pjesa e dhjetë , Neni 148/1/2/3 dhe Neni 148/b, gërma “dh”).

-*Ligjin Nr.97/2016*, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 50/2

-*Urdhërat dhe Udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm* lidhur me raportin vjetor të Drejtuesit të Prokurorisë dhe përmbajtjen e tij si edhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore.


Në përfundim të periudhës kohore 01.01.2018 deri 31.12.2018, paraqesim: “*Raport Vjetor të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë*”, me objektivat e realizuara gjatë ushtrimit të ndjekjes penale në fazën e hetimit paraprak dhe në gjykim, kryerjen e detyrimeve të tjera të parashikuara në ligj nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe administrata e institucionit, analizën me treguesit sasiorë e cilësorë në përgjithësi, por dhe specifikat e tyre.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, ushtron kompetencën tokësore në Bashkinë Gjirokastrë, Libohovë, Dropull, Bashkinë Tepelenë, Bashkinë Memaliaj, si edhe ushtron kompetencën lëndore për vepra penale me të pandehur të mitur ose të dëmtuar të mitur për rrethet Përmet, Tepelenë, Gjirokastrë, Sarandë dhe Delvinë.

Territori ku ushtron kompetencën tokësore dhe lëndore Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë, përfshin sipërfaqe dhe numër popullsie të konsiderueshëm dhe ka patur lëvizje të shumta demografike të shoqëruara me problematika.

Gjatë vitit 2018, në total janë administruar dhe trajtuar pranë kësaj prokurorie 1173 materiale kallzuese, nga të cilat për 400 (*katërqind*) materiale kallzuese është disponuar me vendim mosfillimi procedimi penal dhe 773 materiale kallzuese, është vendosur regjistrimi i procedimit penal. Njëkohësisht janë mbartur 416 procedime penale nga viti 2017, 76 procedime penale nga viti 2016, është ushtruar përfaqësimi në gjykim, ekzekutimi i vendimeve penale dhe marrëdhëniet juridiksionale me shtetet e huaja.

Zyra e Regjistrimit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës Gjirokastrë për periudhën 01.01.2018-31.12.2018, ka evidentuar të regjistruara **773** procedime penale me **187** persona nën hetim, **221** të pandehur, me **80** persona të hetuar me masë sigurimi “*arrest në burg*”.



Janë mbartur për vitin 2018, gjithsej **518** procedime penale me gjithsej **86** persona nën hetim, **88** të pandehur nga të cilët **27** prej tyre me masë sigurimi “*arrest në burg*”.

Nuk është regjistruar asnjë vepër penale e parashikuar nga K.P. Ushtarak.

Në total për vitin 2018 nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë janë hetuar 1291 procedime penale, me 273 persona nën hetim, 309 të pandehur, nga të cilët 107 hetuar me masë sigurimi “arrest në burg”.

Si autoriteti i përcaktuar në ligj për ushtrimin e ndjekjes penale, megjithë situatën kaotike të krijuar, jemi përpjekur të jemi objektivë për një hetim të plotë e të gjithanshëm për të gjitha materialet kallzuese të referuara e trajtuara gjatë këtij viti, për të ngritur dhe përfaqësuar sa më qartë dhe objektivisht akuzën në gjykim, për të ekzekutuar në kohë vendimet penale të gjykatave, për të mbikqyrur në vazhdimësi vuajtjen e dënimit duke mbajtur parasysh politikën e dënimit.

Nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjrokastër, është punuar me seriozitet, duke synuar në këto drejtime:

-Vlerësimi i materialeve kallzuese dhe arritja në një konkluzion të bazuar në ligj për mundësinë e regjistrimit ose jo të procedimit penal. Konstatohet se materialet kallzuese, veçanërisht ato të ardhura nga shërbimet e policisë, si institucioni më i rëndësishëm në luftën kundër krimit, kanë patur problematika të theksuara të cilat përfshijne: mënyrën e konceptimit të akteve nga oficerët e policisë gjyqësore, e cila në shumë raste është jocilësore nga pikëpamja formale (*gramatikore*) por edhe substanciale, çka nënkupton formim të mangët profesional të oficerëve të policisë gjyqësore. Referohen materialet kallzuese dhe në informacionin për referimin e veprës penale, mungon vetë figura e veprës penale. Oficerët e policisë gjyqësore, kryejnë veprime proceduriale për ngjarje e fakte, të cilat nuk janë në kompetencën e tyre lëndore, por janë në kompetencë të organeve të administratës shtetërore, fakte të cilat shpesh përbëjnë kundërvajtje administrative. Pasiviteti i theksuar i segmenteve të caktuara të administratës shtetërore për të kryer detyrat funksionale, ka bërë që organet e policisë të mbulojnë punën e tyre dhe të referojnë në prokurori fakte që nuk përbejnë vepër penale. Pikërisht si pasojë e kësaj shtate vjen numri i lartë i mosfillimit të procedimeve penale.

-Prokurorët kanë synuar hetim profesional, në një kohë sa më të arsyeshme, pavarësisht ngarkesës së lartë dhe rritjes tej mase të vëllimit të punës. Konstatohet se dosjet e deleguara o.p.gjyqësore përgjithësisht nuk punohen me cilësi të lartë prej tyre, shkelen afatet e përcaktuara në urdhërin e delegimit, çka ka ndikuar në cilësinë e hetimit. Sikurse rezulton, pa ndërhyrjen e prokurorit, i cili në këtë rast kapërcen detyrimin ligjor si përfaqësues i akuzës dhe mbikqyrës i hetimit, dhe shndërrohet në opgj, pra pa këtë ndërhyrje hetimi rrezikon të dështojë në shumicën e rasteve.

-Prokurorët e kësaj prokurorie, në përgjithësi kanë komunikime korrekte me palët, subjektet, institucionet apo të interesuarit, por palët jo gjithmonë kanë komunikime korrekte dhe serioze me përfaqësuesit e akuzës. Ushtrojnë trysni, fyejnë, denigrojnë dhe shantazhojnë prokurorët për të arritur në zgjidhjet që u interesojnë, qoftë në fazën e hetimit paraprak, qoftë edhe në gjykim. Në shumë raste prokurorët konceptohen nga palët e interesuara si notere që duhet të ligjerojnë kërkesat e tyre të paracaktuara. Ka raste të evidentuara ku subjekte fizike, pavarësisht se u janë drejtuar organeve të drejtësisë, pas marrjes së vendimeve nga këto të fundit, vendime të cilat nuk i kanë vlerësuar si të drejta, kanë ushtruar vetëgjyqësi, duke shkuar deri në vrasje.

-Prokurort kanë përfaqësim korrekt dhe dinjitoz në seanca gjyqësore. Në këtë drejtim kanë ndikuar edhe masat e marra në vijimësi siç janë sistemi audio dhe video dhe rregullat për ruajtjen e Kodit të Etikës siç janë veshja, orari etj.

-Nga sektori i ekzekutimit të vendimeve penale, është vepruar në mënyrë të shpejtë dhe efikase në procesin e ekzekutimit, duke mbajtur veçanërisht në konsideratë rastet kur prokurori ka ushtruar ankim penal dhe vendimi ende s'ka marrë formë të prerë për persona të arrestuar.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër janë njoftuar në mënyrë koherente udhëzimet dhe janë trajtuar rregullisht në mbledhjet periodike, duke evidentuar në veçanti momentet që lidhen direkt me veprimtarinë e prokurorëve dhe të oficerëve të policisë gjyqësore.

Kjo prokurori ka patur bashkëpunim të ndërsjelltë, pavarësisht mbingarkesës në punë, me Prokurorinë e Përgjithshme dhe institucionet përkatëse me qëllim përshpejtimin e procesit të rivlerësimit profesional të prokurorëve, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve. Informacionet janë dërguar rregullisht, në kohën më të shpejtë të mundur dhe me korrektesë.

Nga ana jonë janë ndjekur çështjet, të cilat lidhen me verifikimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike. Prokuroria disponon rregullore të posaçme për respektimin e standardeve etike dhe profesionale në funksion të forcimit të integritetit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

Në vitin 2018 janë ushtruar funksionet ligjore dhe ato që burojnë nga urdhërat e udhëzimet. Pavarësisht problemeve, të cilat vijnë si pasojë e mungesave në organikë, pra numrit të lartë të procedimeve penale, të papërballueshëm për numrin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë, ka patur dhe ka komunikim e bashkëpunim të vazhdueshëm mes drejtuesit e prokurorëve nga njëra anë dhe prokurorëve e shërbimeve të policisë gjyqësore nga ana tjetër. Niveli i bashkëpunimit ka patur rezultate konkrete, ka vlerësim e mobilizim pozitiv nga këto struktura, por mbeten ende një sërë problemesh, zgjidhja e të cilave do të përmirësonte më tej punën, konkretisht:

- plotësimi i kuadrit ligjor që lidhet me veprimtarinë e policisë gjyqësore dhe shërbimeve të policisë gjyqësore.

- lëvizjet e shumta dhe të shpeshta në organikën e shërbimeve të policisë gjyqësore si edhe niveli jo i duhur profesional.

- mangësitë numerike, profesionale dhe në përvojë konkrete të elementevë të kësaj organike.

- mungesa e varësisë së shërbimeve të policisë gjyqësore nga prokurori. Këto shërbime rezultojnë kryejnë detyra të dubluara, ku shpesh konstatohet se hetimi i dosjeve lihet në plan të dytë dhe në plan të parë vendosen veprimet policore.

Në zbatim të frymës së re kushtetuese dhe detyrimeve të reja ligjore, po merren masat për krijimin e një raporti të drejtë të mënyrës së funksionimit, në përshtatje me të, pavarësisht mangësive dhe faktit që ka ende nevojë për plotësimin e kuadrit ligjor.

Në kuadër të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave, institucioneve tona dhe ato të huaja, në përputhje dhe me urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, janë bërë përpjekje të dukshme dhe konkrete, duke përmendur këto drejtime që paraqesin interes në këtë raport:

Ka tendencë në rritje, në bashkëpunim institucional për hetimet proaktive dhe teknika speciale të hetimit, veçanërisht për kryerjen e hetimeve për vepra penale që lidhen me korrupsionin, pastrimin e produkteve të veprës penale dhe kultivimin apo posedimin e narkotikëve si edhe për kryerjen e hetimeve pasurore. Në këtë drejtim ka ende për të bërë dhe duhen arritur rezultate konkrete në lidhje me numrin e aseteve të sekuestruara në fazën e hetimit paraprak dhe deri në konfiskimin e tyre përfundimtar.

Shpejtësia e hetimit jo e kënaqshme, është ndikuar dukshëm nga ngarkesa e lartë e punës së prokurorëve dhe ndryshimet proceduriale, kurse bashkëpunimi me agjencitë e tjera ligjzbatuese, veçanërisht me organet e policisë mbetet aktiv, përfshi ato ligjzbatuese ndërkombëtare.

Nisur dhe nga ndryshimet e reja ligjore, ka përmirësim të cilësisë së hetimeve të kryera, me qëllim rritjen jo vetëm të numrit të personave të dërguar për gjykim, por edhe rritje të numrit të personave të dënuar me vendim të formës së prerë (kjo për shkak të llojeve të reja të gjyqimit si marrëveshja, urdhëri penal).

Zbatimi i kuadrit të ri ligjor lidhur me drejtësinë për të mitur është realizuar me korrektesë, pra duke garantuar procesin e rregullt ligjor në fazën e hetimit paraprak dhe shqyrtimit gjyqësor.

Hetime të shpejta janë të shumta pavarësisht ngarkesës së lartë dhe respektimi i të drejtave dhe garancive proceduriale ka qenë prioritet, veçanërisht në rastet e veprave penale të dhunës në familje, perndjekje, veprat kundër shendetit si plagosje e lehte apo plagosje e rende.

Zbatimi i kuadrit të ri ligjor në funksion të garantimit të procesit të rregullt ligjor për viktimat e veprës penale në përgjithësi dhe në veçanti për viktimat e dhunës në familje është gjithashtu evident dhe kjo duket dhe nga suksesi në pjesën dërrmuese të rasteve në gjykim.

Bashkëpunimi midis prokurorisë dhe policisë në veçanti, pavarësisht vërejtjeve që përmendëm më sipër, si dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese, është evident dhe me rezultate konkrete. Njoftimet e palëve, përfshi ato të policisë për rastet e përfundimit të hetimeve, apo pushimin e procedimeve për veprat penale të referuara nga vetë ky institucion janë ezauruar sikundër parashikon ligji, me korrektesë.

Në lidhje me përgjimet e kërkuara nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit, kryesisht është proceduar me vendim për lejimin e përgjimit telefonik dhe mandej me kërkesë të prokurorit për vlefësimin e përgjimit nga Gjykata, kërkesa të cilat në përgjithësi janë pranuar. Por nga ana e prokurorëve në disa raste janë ushtruar ankime mbi rrezimin e kërkesave për lejimin e përgjimit telefonik, ankime të cilat janë gjetur të drejta nga Gjykata e Apelit Gjyrokaster dhe është lejuar përgjimi telefonik. Rezulton se megjithë numrin e lartë të përgjimeve të realizuara, ky veprim procedural nuk ka sjelle rezultatet e pritshme. Në analize

te rasteve, konstatohet se pergjimi si mjet per gjetjen e proves nuk është perdorur me efikasitet. Kjo pasi format e komunikimit kane ndryshuar, duke evoluar, perdoren rrjete sociale si viber, messenger, ehatsapp, per te cilat ende nuk zotrohen mjete teknike te posacme per te realizuar pergjimin.

Janë kryer delegime të dosjeve hetimore në drejtorine Vendore te Policise sipas referimeve te kryera prane kesaj prokurorie, por ne kete drejtim jo te gjithë prokuroret zbatojne udhezimin, cfare perben shkelje te detyrimeve te percaktuara ne udhezim dhe ka sjelle zvarritje te hetimit dhe ne keto rrethana ulje te cilesise se hetimit.

Bashkëpunimi ndërinstucional me Ministrinë e Drejtësisë, Kuvendin, Institucionet e Vetingut, Avokatin e Popullit etj., ka qenë korrekt, me qëllim shkëmbimin në kohë reale të informacionit, përmirësimin e cilësisë së akteve, shpejtësisë së kryerjes së veprimeve proceduriale, përfshi dhe ato në kuadër të ekzekutimit të ekstradimeve dhe letërporosive gjyqesore.

Prokurorët janë pjesë e programeve të trajnimit dhe seminareve rregullisht, përfshi ato për specializimin në funksion të njohjes dhe zbatimit të legjislacionit penal për të miturit të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, madje pjesëmarrja ka qenë e rregullt në këtë aspekt. Prokurorët kanë ezauruar programin e detyrueshëm të trajnimit.

Orientimet janë për forcimin e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë. Por per shkak te ngarkeses se larte te dosjeve qe kane ne hetim prokuroret si edhe te aktivitetit te perditeshem ne gjykate, pothuajse e kane te pamundur evidentimin dhe rregjistrimin kryesisht te procedimeve penale, por ne kete drejtim ka patur dhe ka Bashkëpunim me strukturat e policise per hetime proaktive.

II

Në veprimtarinë hetimore është ngritur në një nivel më të lartë respektimi i të drejtave të njeriut, trajtimi i rasteve me të mitur dhe grupet vulnerabël ku do të veçonim disa aspekte konkrete:

Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqesore janë prezent në rastet e kufizimeve të lirisë në momentet e para te kryerjes se veprimeve paraprake hetimore, në veçanti dhe me impenjim maksimal në rastet e ngjarjeve komplekse apo që lidhen me vepra të rënda penale.

Ne çështjet me të mitur, vlerësimi i rasteve si nga oficeret e policise gjyqesore te cilet kane kryer veprimet e para dhe nga prokurorët ka qenë maksimal, dhe nuk konstatohet asnje rast i dështimit te çështjes për shkak të shkeljeve që lidhen me të drejtat e parashikuara ne Kodin e Drejtesise per te mitur (respektohet procesi i drejtë, pjesëmarrja e detyrueshme e mbrojtjes, prania e detyrueshme e psikologut, prinderve, kujedestareve , pra të pranishmëve që detyron ligji etj, gjykimi me dyer te mbyllura, mbajtja e te miturit ne ambiente te posacme si ne paraburgim, por edhe ne procesin e shqyrtimit gjyqesor etj.).

Rastet e të dëmtuarit në procesin penal trajtohen me seriozitet, komunikimi zyrtar me personat ka qenë korrekt dhe në përmirësim të vazhdueshëm. Por ne kete drejtim duhet te qartesohet praktika pasi rezulton se nga ana e te demtuarve gjate procesit te shqyrtimit gjyqesor shkelet etika dhe artikulothen kerkesa jo ligjore.

Ka patur numer te larte te vendimarrjes se prokuroreve per mosfillimin e procedimit penal, i cili sikurse u theksua është 400 raste per vitin 2018. Ky numer i larte ka ardhur per arsytet e sipertreguara dhe perben ngarkese ne punen e prokuroreve. Ne pergjithesi vendimet e prokurorit nuk jane ankimuar , cka nenkupton se vendim-marrja ka qene e bazuar ne ligj.

Ka patur probleme te theksuara me ekspertimet, duke ndikuar negativisht si për zgjatjet e afateve të hetimeve dhe ato të paraburgimit. Nga ana e sherbimeve te policise gjyqesore jane referuar materiale kallzuese pa administruar me pare aktin e ekspertimit mjeko-ligjor. Ky referim prej tyre kryhet pa administruar aktin perkates, pasi kushtezohet nga afatet ligjore te cilat normojne punen e o.p.gj-ve, oficeret kane te limituar afatin per disponimin dhe referimin e materialit kallezues ne prokurori. Per kete qellim është komunikuar me I.M.L Tirane per te marre masa per perpilimin e akteve te ekspertimit brenda nje afati sa me te shpejte kohor, pasi pikerisht nga konkluzionet e aktit te ekspertimit kondicionohet ne shume raste cilesimi i figures se vepres penale, c'ka nenkupton edhe rregjistrimin ose jo te procedimit penal.

Problem veçanërisht i theksuar ka qene dhe mbetet kryerja e akteve te ekspertimit autoteknik, akte te cilat rezultojne te mos jene cilesore ne shumicen e rasteve dhe jo vetem nuk i sherbejne dhenies se drejtesise, por e komplikojne rende situaten. Konstatohet Bashkëpunim,i cili ka dyshime te arsyeshme te mendohet se është kriminal, midis perfaqesuesve te shoqerive te sigurimit dhe eksperteve autoteknike, Bashkëpunim i cili kerkon te zhvesh nga pergjegjesia kryesisht drejtuesit e mjeteve te siguruar te perfshira ne aksidente automobilistike edhe ne rastin kur drejtuesi mjetit rezulton fajtor, c'ka derivon ne zhveshjen nga pergjegjesia materiale te shoqerise se sigurimit qe mbulon mjetin e perfshire ne aksident .Kjo ka sjelle si pasoje nderlikimin e proceseve hetimore dhe gjyqesore.Ne keto rrethana jo vetem kemi filluar procedime penale ndaj eksperteve autoteknike, por kemi sugjeruar dhe vazhdojme te sugjerojme ngritjen nje strukture te posacme, mundesisht brenda insitucionit te policise i cili është institucion me kredibilitet dhe pergjegjshmeri te larte , strukture e cila do te mundesonte kryerjen e ekspertimeve autoteknike sa me objektive. Eksperti autoteknik cmojme se duhet te jete ne perberje te grupit hetimor dhe te paraqitet menjehere ne vendin e ngjarjes per te njohur me provat, mekanizmin e ngjarjes dhe per te dhene ne menyre sa me te shpejte konkluzion shkencor.

Ne rastet e ngjarjeve si :-*“shkelje e rregullave te mbrojtjes ne pune”* si edhe *“mjekimi i pakujdeseshem”*, nga te demtuarit apo te afermit te tyre, shpesh te nxitur nga avokatet mbrojtjes kerkohet drejttesi e disbalancuar, favorizuese, konstatohen nderhyrje trysni e larte ndaj organit te akuzes, me qellim perfitimin e demshperblimeve monetare, duke insistuar ne deklarimin fajtor te mjekeve apo drejtuesve teknike te subjekteve edhe ne rastin kur keta kane respektuar ligjin, pikerisht nisur nga qellime te perfitimit material.Jane evidentuar raste te fyerjes, kanosjes dhe shantazhit ndaj prokuroreve dhe oficerëve te policise gjyqesore te cilet hetojne çështje konkrete.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është paraqitur nje kallzim penal, i cili është rregjistruar si procedim per vepren penale :-*“Shperdorimi i detyres”* dhe është trajtuar me vemendje , pasi karakteristike e tyre çështjeve është se kërkojnë impenjim te larte , veprime hetimore të shumta te shtrira ne kohe, specialiste te fushes dhe kane kosto e lartë e ekspertimeve ekonomiko-financiare.

Ne kushtet e ndryshimeve te kuadrit ligjor, si ato ne “Kodin e Procedures Penale”, “Kodin Penal”, si edhe “Kodin e Drejtesise per te mitur” , cmohet e nevojshme nxjerrja e urdherave dhe udhezimeve nga Prokuroria e Pergjithshme, te cilat lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale, nepermjet te cilave te unifikohet praktika ne nivel kombetar, me qellim permiresimin e punes dhe performances se prokuroreve ne gjykim.

Në vitin 2018 ngarkesa ka qene me e ulet shifra se ne vitin 2017, perkatesisht 70 procedime penale me e ulet. Kjo zbritje ka ardhur si rezultat i efektivitetit te larte te punes se policise ne luften kunder kultivimit dhe posedimit te bimeve dhe lendeve narkotike. Megjithese tendencat e shprehura per kultivim te bimeve narkotike , veçanërisht ne njesine administrative te Tepelenes, kane qene te theksuara, puna e policise ka qene efikase duke parandaluar kultivimin dhe trafikimin e narkotikeve. Pavaresisht uljes se numrit te çështjeve te rregjistruara, ngarkesa e punes se prokuroreve ka qene teper e larte, pasi sikurse u theksua ka patur mungesa ne organike ,veçanërisht është i ulet numri i prokuroreve. Përvec sa me siper, ndryshimet proceduriale kane sjelle situata kaotike me levizjen e dosjeve prokurori-gjykate e anasjelltas. Afati i trajtimit te materilave kallzuese është i reduktuar ne 15 dite, c’ka ka sjelle ne shume raste rregjistrimin e procedimeve te cilat me pas jane pushuar.

Në drejtimin pozitiv mund të përmendim:

- Shpejtësia në hetime ka përparuar dukshëm në procedimin me sukses me urdhera penale, gjykim me marveshje dhe llojet e tjera të gjykimit.
- Në masat e sigurimit, sipas nevojave janë aplikuar masa alternative si “garancia pasurore”, “arrest ne shtepi”, “detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe jane reduktuar dukshem masat e sigurimit te ashpra si arrest ne burg ndaj te pandehurve te mitur
- Është aplikuar denimi aleternativ, puna ne interes publik pa shperblim.
- Është përmirësuar ndjeshëm komunikimi dhe njoftimi për personat dhe institucionet
- Është në nivele të mira koha e paraburgimit, raportet midis kërkesave tona dhe vendimeve të gjykatës ku përfshihen dhe llojet e tjera të gjykimit, është ulur ndjeshëm nevoja e apelimeve, ndërsa ka qenë pothuaj i panevojshëm aplikimi i apelit kundërshtues
- Procedimi me ekzekutimet është në nivele shumë të mira

Rastet kur janë konstatuar mangësi në këtë aspekt lidhen me ngarkesën e punës, zgjerimin e komunikimeve ndërinstiucionale dhe kërkesat e shumëfishuara për informacion të paraqitura nga palë, persona, shoqata, institucione, studiues, apo edhe studiues te dyshimte në kuadrin dhe të ndryshimeve ligjore të viteve të fundit, e veçanërisht te ligjit: “*Per informimin*”, por në kushtet e një personeli të kufizuar.

Pavarësisht interesit pozitiv te kerkuesve ,në shumë raste këto kerkesa marrin shume kohe e energji dhe pengojnë ushtrimin e funksionit në një kohë sa më të arsyeshme, kur duhet pranuar se vazhdon një klimë jo pozitive ne publik ndaj organeve te drejtesise , por që nuk ka arritur të ndikojë dukshem në veprimtarinë ligjore funksionale.

Kemi qene korrekte në komunikimet publike e ato të lidhura me procedimet konkrete, por cmojme se me kalimin e kësaj situata tranzitore reformuese do të arrihet të krijohet një kuadër ligjor që do

ta fokusonte prokurorin veçanërisht në kryerjen e detyrave funksionale dhe krijimin e një imazhi më të qartë të publikut për atë ç'ka bën dhe duhet të bëjë ky institucion.

Konstatohet se në fushën e ndihmes gjyqësore penale me autoritetet e drejtësisë së shteteve të tjera ka patur komunikim të rregullt e të ndërsjellte, duke përjashtuar autoritetet e drejtësisë së R.Greqisë, të cilat konstatohet se jo në të gjitha rastet i ekzekutojnë dhe i dergojnë aktet brenda një periudhe kohore, periudhe e cila do të shërbente produktivitetit të hetimit, por rezulton të ekzekutohen lehtëporosite dhe të dergohen pasi kanë kaluar afatet e parashkrimit.

-III-

Nga problematikat e evidentuara mund të përmendim:

Në rrethanat kur numri i prokuroreve është i ulët në raport me ngarkesën e punës, ka qenë e pamundur të funksionojnë sektoret, si sektori i të miturve, njesia e posacme, e cila ka marrë atributet e ish NJPH-Task-force dhe në këto rrethana çështjet janë shpërndarë sipas shortit elektronik. Pavarësisht parashikimeve ligjore, në mungesë të kancelarit, zv.drejtuesit, sektoreve perkates, si edhe numrit të paket të prokuroreve, një sërë detyrash shpërndahen tek të njëjtët persona. Drejtuesi dhe kryesekretarja kryejnë disa funksione. Aktualisht drejtuesi i prokurorisë ka në hetim 155 procedime penale, ndërkohë që çështjet e ndryshme, problemet e administrimit dhe të dokumentacionit, arkiva, mardheniet me publikun dhe ato insitucionale, por sidomos kërkesat për informacion po rriten në mënyrë gati të papërballueshme. Kjo ndikon detyrimisht dhe në mundësinë e ndërhyrjes së drejtuesit në masë në kontrollin e çështjeve konkrete. Por njëkohësisht i heq mundësinë drejtuesit të kryej detyrat funksionale.

Drejtuesi vihet kryesisht në lëvizje nga ankesat, dijeni publike apo akte që paraqiten nga palët dhe ka ndërhyrë për sa është e mundur duke proceduar dhe me zëvendësimet përkatëse të prokuroreve kur është cmuar se ka patur baze ligjore, apo ka qenë e nevojshme me qëllim të ruhet kredibiliteti i insitucionit.

Dispozitat që përcaktojnë pavarësinë e prokurorëve, largojnë dukshëm efektet e ndërhyrjes së drejtuesit, ndërsa politika penale mbetet e vështirë për tu mbajtur në nivelin e duhur në rang prokurorie. Në fakt duhet të shkohet drejt pavarësisë së plote të prokuroreve në ushtrimin e ndjekjes penale, pa asnjë lloj ndikimi nga persona apo subjekte, ku perfshihet edhe keshilla e dhene drejtuesi i prokurorisë, pasi kjo është edhe fryma e ndryshimeve në ligj dhe një nga risite kryesore që sollen këto ndryshime. Dosja hetimore duhet të jetë ekzkluzivitet vetëm i prokurorit që ushtron ndjekjen penale dhe o.p. gjyqësore të cilit ai i ngarkon hetimin, pasi në këto mënyre ruhet edhe sekretet hetimor. Kontrolli i hetimit dhe veprimeve të kryera nga prokurori në mënyrë të qartë është përcaktuar të bëhet nga gjykata në seanca të posacme dhe në këto rrethana kontrolli i ushtruar dhe keshillat me shkrim nga drejtuesi ndaj prokuroreve cmojnë se janë në kundërshtim me frymën e Kodit të Procedurës Penale të ndryshuar.

Rritja e numrit të çështjeve penale, procedurat e reja, kërkesat e pafundme për informacion po krijojnë një situatë kaotike dhe kjo padyshim ka ndikim në ritmin dhe ecurinë e punës në ecurinë e hetimit të çështjeve si edhe në cilësinë e dobët të hetimit.

Sistemi i menaxhimit të çështjeve manifeston probleme, administrata nuk mjafton as për çështjet penale dhe detyrat e tjera parësore, si dhe ka nevojë për ndërhyrje për shkak të cilësisë dhe ndryshimeve të reja procedurale, po ashtu dhe për një bazë më të mirë materiale.

Shorti elektronik funksionoi rregullisht pergjate një pjesë të vitit dhe është proceduar rregullisht me shortin manual apo ndarjen e rasteve në bazë të urdhërimeve ligjore të prezantuara që më parë nga drejtuesi për të evituar çdo problem. Në këtë aspekt, me shortin elektronik duhet përmirësuar situata teknike, pasi nuk garantohet sipas shortit shpërndarja në nivele të barabarta e çështjeve të shortuara dhe mbetet e vështirë më tej që të realizohet dhe kompensimi me shortin manual të çështjeve për të balancuar ngarkesën e prokuroreve.

Politika penale nuk është me e unifikuar sic ka qene me pare, kjo per shkak te pavarësisë së prokuroreve, pasi është i mangët dhe praktikisht problematik vështrimi krahasimor nga gjykata apo vet prokurorët.

Pavarësisht orientimeve të vazhdueshme të drejtuesit mbajtja e një niveli të përgjithshëm më të mirë mbetet i cënuar. Kjo situatë përfshin dhe qëndrimin në masat e sigurimit si edhe në masat e denimit dhe konstatohet dukshëm se është evidente kerkimi dhe pranimi i kerkesave për rritje e dënimeve alternative apo të disballancuara midis prokuroreve të ndryshem.

Trajnimet e përbashkëta janë koherente, por ka emergjencë për trajnimet specifike të oficerëve të policisë gjyqësore, të cilët janë një hallkë shumë e rëndësishme e hetimeve.

Ka mangësi të dukshme teknike në rritjen e aksesit dhe përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore.

Rritja e cilësisë së mbajtjes dhe raportimit të të dhënave statistikore është e dukshme, por problemet teknike me sistemin, administrata e kufizuar në numër, ngarkesa në punë dhe mosimplementimi tërësor i ndryshimeve të reja ndikojnë jo pak në këtë aspekt.

Në kuadrin e profesionalizimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimit të sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit është e nevojshme rritja e numrit dhe cilësisë së pajisjeve, sidomos ato kryesore për ushtrimin e funksionit, por dhe e mundësive paguese për nevojat e përhershme apo specifike të punës.

Të dhënat statistikore që kërkohen krijojnë shpesh një ngarkesë tej çdo norme, sidomos për faktin se nuk rakordojnë me statistikat bazë nga ndryshimet e reja dhe mangësite administrative e shtojnë problemin. Po të shtojmë këtu dhe komunikimet me institucionet është gati e pamundur të procedohet më shpejtësi.

Kallzimet nga subjektet në masë të gjerë nisen nga situatë që përbëjnë shkelje administrative apo thjesht për të shoqëruar përgjegjësinë administrative. Njoftimet dhe procedurat shpesh pengojnë ritmin e punës dhe rrisin kostot. Problemet juridike krijojnë pengesa në vlerësimet dhe ndikojnë në kohën e punës dhe zgjidhjen e problemeve. Efektivi ka qenë i mangët, administrata ka patur mangësi në raport me kërkesat për shkak të lëvizjeve, ndërsa janë vetëm tre oficerë të policisë gjyqësore dhe shërbimet kanë përherë problemet e lëvizjeve.

-IV-


Nga të dhënat krahasuese të përgjithshme mes dy viteve të fundit evidentohet:

GJATË VITIT 2017:

<u>Procedime</u>	<u>Mbartur</u>	<u>Gjykim</u>	<u>Pezullim</u>	<u>Pushime</u>	<u>Mosfillime</u>
844	454	267	260	140	349

GJATË VITIT 2018:

<u>Procedime</u>	<u>Mbartur</u>	<u>Gjykim</u>	<u>Pezullim</u>	<u>Pushime</u>	<u>Mosfillime</u>
773	518	280	137	80	400



Në një këndvështrim të përgjithshëm rezulton se veprat penale nga më të përhapurat kanë të njëjtën tendencë gjatë këtij viti:

-veprat penale më të përhapura janë në nivele të përafërta, pothuajse te barabarta me një vit më parë.


-mbeten problem vjedhjet, posedimi i narkotikëve, drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt, kalimi i paligjshëm i kufirit, përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike, dhuna në familje.

-veprat që lidhen me narkotikët kanë tendencë ngritje (*kultivimi i narkotikeve*; - janë rregjistruar procedime 18 raste me shume se ne vitin 2017). Kjo nuk nënkupton se ka patur me teper kultivim te bimeve narkotike se vitet e kaluara, por ka patur me teper force

zbuluese dhe evidentuese nga organet e policise dhe per goditjen e ketij aktiviteti kriminal. Ne lidhje me vepren penale:-“*Prodhimi dhe shitje e narkotikeve*” ka tendence ulje(*jane rregjistruar 11 procedime me pak nga viti 2017*).



-ka tendencë në rritje per vepren penale:-“ *kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror*”, (*jane evidentuar 20 raste me teper nga viti 2017*)situatë që lidhet me shumë faktorë, e cila në prespektivë të integritimit krijon probleme reale.Kjo situatë pritet te perkeqesohet ndjeshem dhe ende nuk është e mundur te parashikohen pasojat.Ne pergjithesi shtetasit shqiptare, nuk shkojne ne vendet e bashkimit europian per turizem apo biznes , por per shkaqe ekonomike. Ata kerkojne te punesohen ne menyre afatgjate, duke shkelur ne kete menyre afatet e qendrimit ne zonen “Shengen”, c’ka detyrimisht i ngarkon me pergjegjesi administrative dhe i shenderron ne persona te padeshiruar dhe ne keto rrethana i kondicionon te kalojne kufirin ne menyre te paligjshme, ilegale, pasi rikthehen per te kerkuar pune ne vendet e Bashkimit Europian. Referuar te dhenave nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit Gjirokaster, kalimet e paligjshme jane ne numer te larte edhe pse ne shume raste është e pamundur te evidentohen dhe cmojme se kjo situatë mund te shnderrohet se shpejti ne emergjente. Konstatohet se struktura te veçanta te D.K.Migracionit pergjate brezit te gjelber, por shpesh edhe ne pikat e kalimit kufitar , pra punonjes policie te nivele baze, jane te perfshire ne aktivitetin e ndihmes per kalimin e paligjshem te kufirit, pikerisht per shkak te kesaj situatë te krijuar.

-ngarkesa e larte e numrit te çështjeve per prokuror ,por edhe detyrave te tjera qe burojne nga K.Pr.Penale krijon probleme për hetimet proaktive dhe ato kryesisht dhe pse janë në tendencë pozitive




Më poshtë paraqitet përhapja e veprave penale në territor, të trajtuara gjatë vitit 2018, ku përfshihen çështjet e mosfilluara dhe ato të rregjistruara, sipas grupimeve në Kodin Penal ku kemi veçuar:


- Kreu II Vepra penale kundër personit, krime kundër jetës
- Kreu III Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike
- Kreu IV Vepra penale kundër mjedisit
- Kreu VIII Krime kundër autoritetit të shtetit
- Kreu IX Vepra penale kundër drejtësisë




Kreu IV (Nenet 201 - 207)



Kreu VIII (Nenet 235 -299)




Kreu IX (Nenet 300 - 324/a)



Nga hetimet dhe vlerësimet konkrete në territorin që mbulon kjo Prokurori rezulton si me poshte:

- Vazhdon te jete e përhapur dhe aktuale *vepra penale në fushën e narkotikëve*, sidomos tashmë posedimi , ndërkohë që mbetet problematike situata me vjedhjet e pasurise, ndihma per kalim te paligjshem te kufirit, kalim i paligjshem i kufirit, dhune ne familje, perndjekje.
- shkaqet e përhapjes së tyre janë të ndryshme:- sociale dhe ekonomike, probleme të infrastrukturës dhe edukimit të pamjaftueshëm në respektimin e rregullave e ligjeve, mosfunksionimi i rregullt i strukturave të ndryshme shtetërore që mbikqyrin veprimtari të palejuara dhe në shkelje të ligjit
- ka tendencë në rritje, madje është teper shqetësuese dhe krijon ngarkesë fiktive fakti se kallzohet për raste që nuk lidhen me veprimtarinë e organeve të ndjekjes penale, pasqyruar kjo dhe në vendimet e shumta të mosfillimit te procedimit penal. Kjo vjen si rezultat i pasivitetit te administrates shteterore ne zgjidhjen e probleme dhe shqetesimeve te qytetareve.
- veprat penale dhe personat e hetuar e gjykuar kanë një shpërndarje të drejtë në raport me shpërndarjen e popullsisë, sipas numrit dhe territorit, por rezulton te kete me shume autore me banim ne qytet se ne fshat, 305 autore me banim ne qytet dhe 231 ne fshat.
- numri i të hetuarve meshkuj dominon dukshem, po ashtu ashtu dhe i personave të papunë, numri i personave përsëritës është rritur ,dominojne perseritesit ne veprat penale:-vjedhje, kalim i paligjshem, është rritur numri i masave të sigurimit 154 per 2018 nga 133 qe kane ne 2017 .
- arrestimet në flagrancë ne vitin 2017 jane 122 kurse ne 2018 jane 134 , pra janë në një masë më të madhe, ndalimet nga policia gjyqesore jane rritur kete viti, pra 09 per vitin 2017 dhe 16 per vitin 2018.
- masat e sigurimit janë pranuar nga gjykata cfare ka sjelle si rezultat që jane ulur ndjeshëm apelimet
- aplikimet e procedurave të reja kanë tregues pozitivë, si kërkesat në gjykatë, urdhërat penale, marrëveshjet etj.




-VI-

Në lidhje me strukturën e legjislacionit penal dhe subjektet vërejmë:-

- raportet midis krimeve dhe kundërvajtjeve penale dominohen nga krimet.
- raportet për vendbanimin e subjekteve, qytet-fshat, tregojnë rritje të implikimit të banorëve të zonave urbane, megjithëse dihet se ka levizje demografike me tendence zhvendosjen drejt qyteteve dhe qendrave të rëndësishme urbane.
- në lidhje me gjininë e subjekteve është qartësisht evidente epërsia e subjekteve meshkuj.
- midis subjekteve kemi patur dhe shtetas të huaj të cilët kanë patur rritje si autor të veprave penale.
- niveli i ulët arsimor i subjekteve është gjithashtu evident.
- pavarësisht nivelit më të lartë të veprave penale dhe autorëve në zonën rurale, ulja e kultivimit të narkotikëve dhe rritja e vjedhjeve në zonën urbane janë përcaktuese në raportet krahasuese
- dukuri e veçantë mbetet tendenca e afrimit të kontigjentit kriminal nga jashtë territorit ku kemi kompetencën tokësore, kjo për shkak të kufirit të gjelër me R.Greqise.
- mbetet shqetësues kategoria e përdoruesve të narkotikëve që kthehen lehtësisht në subjekte të veprave penale ndaj personit, dhunes në familje dhe vjedhjes së pasurisë dhe kuptohet dhe në fushën e narkotikëve
- është rritur numri i subjekteve të mitur, c'ka ka lidhje me demtimin e familjes si qeliza baze të shoqërisë, të sistemit arsimor dhe edukativ dhe indiferencës së përgjithshme të shoqërisë.

- niveli i lartë i papunësisë dhe faktorët ekonomikë janë burim i rëndësishëm i një kategorie të gjerë krimesh dhe subjekte

Treguesit e subjekteve 2018



Gjatë vitit 2018:


-është proceduar me *masa sigurimi* mbi bazën e arrestimeve në flagrancë dhe urdhërave të ndalimit të policisë.

-është proceduar me kërkesa për caktim masë sigurimi

-nuk ka patur raste për urdhërimin e lirimit të menjëhershëm


-arrestimet në flagrancë janë kryer më tepër për disa vepra penale:- Nenet 121/a, 130/a, 134/2, 283;284,290, 291, 298 të K.Penal

Vlerësimet nga gjykata janë pozitive dhe pothuaj në masën më të madhe qëndrimet tona janë vlerësuar të ligjshme dhe masat e sigurimit janë pranuar nga gjykata, kjo dhe për faktin se kemi vlerësuar me kujdes rastet dhe nevojat e sigurimit. Tendencë e dukshme ka qenë ndërhyrja e prokurorit që në momentet e para.



Në dënimet gjatë vitit 2018:

- ka patur një shpërndarje jo shumë të drejtë, ku kanë nisur të dominojnë ato alternative, përkrahur në masë nga gjykata, vlerësuar dhe rast pas rasti për arritjen e qëllimit të dënimit
- janë kërkuar dënime të rënda edhe maksimale
- vazhdon të aplikohet gjatë këtij viti pezullimi i ekzekutimit dhe zëvendësimi i dënimit me punën në interes publik pa shpërblim.
- janë aplikuar dhe masa dënimi me gjobë të përshtatshme, por mbetet problem shlyerja e tyre
- ndryshimet e reja kanë ndikuar në mospasjen e një praktike të qartë të politikës së dënimit.



Në zgjidhjet përfundimtare të çështjeve kanë ndikuar:

- ulja e afatit për mosfillimet
- qëndrimi i përgjithshëm për vlerësimin më serioz të çështjeve
- rritja e pavarësisë së prokurorëve
- referimi i materialeve pa vlera juridike penale
- kallzimet formale të shtetasve
- rritja e nivelit të kallzimeve
- ndryshimet proceduriale

Kryesisht çështjen janë pushuar “për mungesë fakti”, ketu përfshihen si rastet kur është konstatuar se fakti nuk ekziston, edhe ato kur fakti nuk përbën veprë penale. Çështjet e pushuara për mungesë të provave zënë një vend shumë të vogël në totalin e çështjeve të pushuara nga kjo prokurori, çka tregon për përpjekjet e bëra për të provuar akuzat në

ngarkim të personave ndaj të cilëve ushtrohet ndjekje penale. Rezulton te kete dhe çështje të pushuara “për shkaqe të tjera procedurale” ku vendin kryesor e zënë ato që kanë të bëjnë me heqjen dorë nga ankimi prej të dëmtuarve për ato procedime ku ndjekja penale është e kushtëzuar nga vullneti i tij.

Në vitin 2018 janë ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjirokaster , nga palet e interesuara vendime pushimi dhe mosfillimi të procedimit penal, nga të cilat për rastet konkrete kanë rinisur hetimet, por gjithsesi janë në rritje. Konstatohet se në vazhdimësi Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokaster, ka perkrahur kerkesat e paleve, duke shfuqizuar vendimet e mosfillimit apo ato te pushimit te arsyetuara nga prokuroret , qendrime te cilat jane perkrahur shpesh nga Gjykata e Apelit. Nga ana jonë mbetet që të thellohen më tej vlerësimet për këto raste dhe ne kete menyre të ulet më tej numri i rasteve ku gjykata mban qëndrim të ndryshëm. Apelimet kane ruajtur pothuajse te njejtin nivel me vitin 2017, ndërsa apele kundërshtues nuk ka patur.

Gjatë vitit 2018 janë pezulluar 137 çështje penale. Mbetet shqetësuese problematika e vjedhjes se pasurise dhe kultivimi narkotikeve. Ato zënë përsëri vendin kryesor, ndërsa ka rritje dhe për vepra të tjera, përfshi dhe ato me pasoja të rënda sic jane plagosja e rende , vrasja, vjedhja me dhune e me arme, vjedhja e bankave, shkaterrimi i prones me eksploziv. Vendimet e pezullimit janë marrë pasi janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore, duke i kushtuar rëndësi të veçantë kryerjes së veprimeve në vendin e ngjarjes, fiksimit të provave në formën e parashikuar në ligj, etj. Ka qene dhe mbetet e detyrueshme ne baze te udhezimeve prania e prokurorit ne vendngjarjet me pasoja te renda si aksidente dhe vrasje. Për këtë qëllim ka patur komunikim të përhershëm me oficerët e Seksioneve dhe Shërbimeve të Policisë Gjqësore, si dhe drejtuesit e tyre për përmirësimin cilësor të kryerjes së veprimeve hetimore në fazën e hetimit paraprak.

Numri i procedimeve penale të pezulluara mbetet ende i lartë. Arrija e rezultateve kërkon një koordinim më të mirë të punës midis strukturave të policisë, por edhe ndërmjet prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjqësore.

Mbetet shqetësues dhe lëvizja apo mangësitë në personelin e shërbimeve të policisë gjqësore. Në këtë kontekst është e nevojshme dhe rritja e rolit drejtues e kontrollues të prokurorit në hetimin paraprak, për më tepër në frymën e ndryshimeve të reja ligjore, duke parë në vazhdimësi ligjshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore nga ana e tyre dhe vlerësimin korrekt të veprimtarisë së tyre. Nga puna serioze do të kete zbulueshmeri te autoreve dhe rifillime të hetimeve me sukses për procedime të mëparshme, të pezulluara për moszbulim autori.

Në vitin 2018 janë dërguar për gjykim 280 procedime penale, duke zënë një pjesë të konsiderueshme në totalin e procedimeve penale. Treguesit e çështjeve të dërguara në gjyq janë në parametra tepër pozitivë duke ju përmbajtur gjithmonë parimit për të dërguar në gjyq ato procedime për të cilat ka pasur një bazë të mjaftueshme të dhënash hetimore paraprake për provueshmërinë e akuzës në ngarkim të personave të pandehur, për më tepër ka një garanci më shumë që është gjykata. Për veprat penale të rënda si:- krimet kundër personit,

pasurisë, por edhe për vepra të tjera të përhapura në territor hetimet ndaj autorëve të dërguar për gjykim janë ndjekur në gjendje arresti ne burg.

Gjatë vitit 2018 janë hetuar dhe e gjykuar me sukses 653 procedime për vepra të ndryshme penale. Nga procedimet e dërguara për gjykim pjesën kryesore e zënë procedimet e regjistruara mbi bazën e materialeve të referuara nga organet e Policisë së Shtetit si dhe nga qytetarët.

Në vitin 2018 kanë vazhduar të aplikohen me sukses gjykimet sipas Kodit të ndryshuar të Procedurës Penale, me efekte të dukshme pozitive. Mbeten gjithashtu problematika të gjera në trajtimin dhe vlerësimin e situatave të reja procedurale, në kërkesat, gjykimet, fazën e ekzekutimeve etj.

Ngarkesa mbinormale ne pune e prokuroreve ndikojnë dukshem negativisht në shpejtësinë dhe cilesine e hetimit. Njoftimet janë problemi i ri i kërkesave në gjykatë dhe gjykimeve, situata sjell zvarritje dhe shpesh mosarritjen e qëllimit efektiv. Moimplementimi ende i sistemit te adresave, largimet pa adrese nga njesia administrative, lëvizje apo banime të shumta në shtetin grek dhe shtete te tjera duke bere praktikisht në masë të madhe në mosgjetjen gjetjen dhe duke bere te pamundur njoftimin e personave, te pandehur apo deshmimtare.


Gjate vitit 2018 Prokuroria e Gjirokastrës ka apeluar 9 vendime themeli, nga të cilët 6 për pafajsi, 1 për ndryshim kualifikimi dhe 2 vendime për masë dënimi më të butë.

Nga 4 apeline të prokurorisë Gjirokastrë për rëndim të pozitës së të pandehurit, Gjykata e Apelit nuk ka pranuar asnjë rast, në 2 vendime ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së pare, në një vendim ka vendosur pushim çështje dhe në një vendim ka vendosur kthim për rigjykim.

Nga 4 apeline të Prokurorisë Gjirokastrë për vendime pafajsie, Gjykata e Apelit në 3 raste ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të shkallës së parë dhe në 1 vendim ka vendosur fajësi, për të gjitha këto vendime(pafajsi) nga Prokuroria e Apelit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga shqyrtimi i 7-të apelineve të Prokurorisë Gjirokastrë, Gjykata e Apelit në 1 vendim ka pranuar apelimin duke vendosur masën e sigurimit “arrest burg”, në 6 vendime ka miratuar (lënë në fuqi) vendimin e gjyktës së shkallës së pare.

Në apelimet rastet më të shumta janë ato nga të pandehurit, ku pothuaj në shumicën e rasteve paraqitet ankimi.



Në vitin 2018 është vendosur mosfillimi për 400 raste të kallzuara apo referuara. Për të gjitha këto raste, është treguar vemendje që vendimi të arsyetohet dhe të merret brenda afatit të përcaktuar në ndryshimet ligjore proceduriale.

Në zbatim të detyrimeve të ligjit procedural penal, personave të interesuar, subjekte fizike ose juridike, i'u janë komunikuar vendimet e mosfillimit, duke u dhënë mundësinë për të ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatë. Në përgjithësi ka numër të lartë të ankimeve të vendimeve të mosfillimit, vendime të cilat në pjesën dërrmuese janë shfuqizuar nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit. Rezulton se nga vendimet e shfuqizuara, pas kryerjes së veprimeve hetimore sipas detyrave të lëna nga gjykata dhe atyre të diktuar nga dinamika e hetimit, çështja nuk është dërguar për gjykim me akuze. Kjo nga njëra anë tregon se vendimmarrja e prokurorit ka qenë e bazuar në ligj dhe nga ana tjetër vertetohet se gjykatat kanë mbajtur qëndrim oportunist, për të mos u paragjykuar negativisht nga pala kallzuese, sikurse ndodhë rëndom në praktike.

Niveli i ulët i njohurive juridike, interesi subjektiv, shpesh edhe material, ndikojnë negativisht në numrin e lartë të ankimit të shumë vendimeve të mosfillimit të procedimit penal.

Është krijuar praktike negative tashmë nga shërbimet e policisë gjyqësore, të cilat gjenden nën trysinë e paleve, shërbime të cilat nëse nuk dokumentojnë kallzimet e ushtruara, do të paragjykojnë se nuk kryejnë detyrën dhe në këto situata o.p.gjyqësore dokumentojnë dhe dërgojnë në prokurori materiale kallezuese, të cilat në mënyrë të qartë nuk përbejnë figura të ndonjë veprë penale, rezulton se nuk janë objekt i punës së tyre dhe se përbejnë kudervajtje administrative të cilat janë në kompetencë të organeve të tjera të administratës shtetërore, organe të cilat sikurse theksuan qëndrojnë në pasivitet të plotë. Këtu mund të përmendim Inspektoriatin Ndërtimor Vendor, Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Inspektoriatin e Mjedisit, ZRPP-ajteshme, Zyrrat e Përbërimit, O.S.H.E, e cila jo vetëm nuk ushtron kallzime

por ne menyre te perseritur mbifaturon qytetaret duke u sjelle shqetesime serioze. Krijohet bindja se mekanizmat e ankimit dhe strukturat qe merren me analizimin dhe zgjidhjen e ankesave te qytetareve, jane krijuar te tilla qe te vonohet ose te mos i jipet kurre zgjidhje problemeve qe percjellin qytetaret.

Organi me i rendesishem per zbatimin e ligjit mbetet policia , organ me te cilin, pavaresisht verejtjeve te shprehura kemi shkallen me te larte te Bashkëpunimit dhe mirkuptimit.

Pavaresisht se prokuroria aktualisht është nga organet e vendosur ne poziten e te dyshuarit prej publikut, perseri ne menyre te cuditeshme, se bashku me policine është nga institucionet i cili gezon shkallen me te larte te besimit, pasi qytetaret ne vijimesi per cdo problem dhe shqetesim penal ose jopenal drejtohen ne polici dhe ne prokurori. Ky besim duhet te perligjet duke iu sherbyer me korrektese.

-VII-

Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore te kesaj prokurorie , kanë përballuar numër të konsiderueshëm rastesh, duke nisur nga referimet nga policia gjyqësore, kallzimet dhe ankimet nga shtetasit, procedime apo kallzime të ardhura për komptencë, perfaqesime per çështjet e derguara per gjykim, te pushuara, te ankimuara , përfaqësime në gjykimet e themelit dhe ato me palë të dëmtuara, përfaqësime në gjykime me objekt në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale apo marrdhëniet me autoritetet e huaja.

Në lidhje me urdhërat e ekzekutimit, nga ana e prokurorit të ekzekutimeve, urdhërat janë nxjerrë në kohën e duhur dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr.8331, datë 21.04.1998 për "*Për ekzekutimin e vendimeve penale*" si dhe duke respektuar Urdhërat dhe Udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm në këtë drejtim.

Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për vitin 2018 janë nxjerrë 302 (253 urdhra viti 2017) Urdhëra për ekzekutim, nga te cilet 53 (91 viti 2017) urdhëra për vendime që përmbajnë dënime me burgim , 90(29 viti 2017) urdhëra për vendime që përmbajnë dënime me gjobë dhe 117(120 viti 2017) per denim me kusht, pra aplikimi i nenit 59 K.P si edhe 42(13 viti 2017) ne aplikim i nenit 63, pra pune ne interes publik.

